



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM
DREJTORIA E PERSONELIT DHE INSPEKTIMIT

Nr. 1731 Prot.

Tiranë, më 5 . 09 . 2002

GJITHË PROKURORIVE TË RRETHEVE

PËR GJITHËSIM

Mbi shkeljet e ligjit penal e procedural Urdhrave dhe Udhëzimeve te Prokurorit te Përgjithshëm, të konstatuara gjatë kontrollit ne Prokurori të Rrethit Tiranë

Në mbështetje të nenit 9 germa " ç " dhe 42 të Ligjit nr. 8737 datë 12.02.2001 " Për Organizimin dhe Funksonimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë " dhe Urdhrave të Prokurorit të Përgjithshëm, u krye kontrolli në Prokurori të Rrethit Tiranë, për vitet 2000 -2001 dhe procedimet për

N të Prokurorit të Përgjithshëm, zvarritje për shkaqe subjektive, si dhe mangësi serioze, ne organizimin e punes.

Drejtimet kryesore të ketyre problemeve[^] ligjore po i paraqesim më poshtë :

1- Shkelje te kërkesave të neneve 287,323 e 324 të KPr.Penale në regjistrimin e procedimeve penale, dhe zgjatjen e afateve të hetimit.

Ne keto drejtime u evidentuan shkelje dhe intrpretime te gabuara te ligjes procedurale dhe Urdherit te Prokurorit te Pergjithshem Nr.157/1,2,3 dhe 4 date 24.10.2000.Neshume dosje mungonin vendimet per zgjatjen e afateve te hetimit,me pretendimin se emri I personit qe latribuohej vepra penale,duhej shkruar ne regjistrin e procedimeve penale kur atij ti hjoftohej akuza.Keto qendrime u konsideruan shkelje e ligjes procedurale.Procedime penale te mbartuar nga viti 2001 dhe pa vendiine te zgjatjes se afatit- te hetimeve u gjeten ne shume prokurore por per tu permendur jane:Artan Tozaj,Arban Tutulani dhe Dritan Ribaj ne 7 procedime penale,Gjon Kodra ,Sajmir Hysa dhe Shkelqim Garii ne 6 procedime penale,Kudusi Shahu 6 procedime penale dhe Irena Vujoshi 4 procedime penale.

Gjithashtu u konstatuan dosje penale te pushuara te mbajtura ne hetim mbi 3 muaj dhe pa vendime te zgjatjes se afatit.Konkretisht procedimet penale te vitit 2000:Nr.1168 e 790 te prokurorit Adnand Xhelili;Nr.1160,1367,1368 te prokurores Dolorez Velaj;Nr.1148 e 802 te prokurorit Dritan Ribaj;Nr.1814 e prokurores Violeta Veshi etj.

2-Shkelje te kerkesave te neneve: 30/2, 290 e 291 te K.Pr.Penale,per urdherat e delegimit dhe vendimet e mosfillimit te procedimeve penale

Ne shume raste urdherat e delegimit u gjeten skematike, te pergjitheshme, te ceketa dhe me kryesorja pa afate konkrete per kryerjen e detyraves hetimore. Ne kete nivel ju gjeten urdherat e delegimit prokuroreve: Ened Nakuci, Bledar Bejko, Dritan Ribaj, Sajmir Hysa, Petrit Fusha, Artan Tozaj etj. Po japim nje rrast konkret nga ky ifundit. Ne urdherat e procedimeve penale Nr.1164 dhe 1152 te vitit 2000 percaktohen vetem dy detyra:1-.Te meret deshmija e penalitetit. 2-Te kryhen veprimet e tjera.

Studimi me kujdes i materialeve denoncuese, me qellim per tju dhene zgjidhje konform ligjes, eshte detyre e cdo prokurori, zv/prokuroreve dhe titullarit te prokurorise.

Ne kete prokurori u evidentuan shkelje lidhur me zbatimin e ketyre neneve te K.Pr.Penale. Jane regjistruar disa ceshtje penale, ndonese me gjendjen e akteve te kallzuara ka qene e plote tabloja per te mare vendimin e mosfillimit te procedimit penal. Ne kete drejtim duhet bere kujdes vecanerisht per ato denoncime qe behen mbi bazen e dokumentave te fotokopjuara, kur ligja kerkon ne menyre kategorike dokumenta origjinale.Psh. Denoncimet e Degeve te Doganave ose organeve te tjera apo subjekteve private,per taksat tatimet ose fallsifikimet e dokumentave. Ne Prokurori te Rrethit Tiranejshin regjistruar ne vitin 2000, njezet procedime penale per krimin e kontrabandes neni 174 i Kodit Penal,kur materiali kallzues ishte I vitit 1997, pa asnje dokument origjinal, vetem i fotokopjuar. Nga ekspertimet kontabile qe kreu prokuroria rezultoi se ishin shlyer qe ne ate vit detyrimet doganore nga te gjitha keto subjekte private.Kjo beri qe keto ceshtje me te drejte te pushohen, ne vend qe ato te zgjidheshin konform ligjes me vendime mos fillimi, te cilat u duhen njoftuar menjehere denoncuesit dhe personave qe kane bere ankim.

3-Disa shkelje te ligjes penale e proceduriale, Urdhërave dhe Udhezimeve të Prokurorit të Përgjithshëm, gjatë hetimeve paraprake, pushime të pa bazuara te ceshtjeve dhe zvarritje në kryerjen e veprimeve hetimore.

Në punën hetimore të kryer nga oficerët e policisë gjyqësore, nën drejtimin e prokurorëve, si dhe në ato veprime të cilat duhet të kryhen direkt nga prokurorët,mbasi është kërkesë e detyrueshme e procedurës, jo në pak raste u konstatuan paplotshmeri hetimi, shkelje dhe të meta të cilat reflektojnë neglizhencë e mungesë profesionalizmi nga vetë prokurorët por edhe mungesë kontrolli nga drejtuesit e prokurorisë. Më konkretisht:

-Janë bërë kërkesa për masa sigurimi, të papërshtateshme me rrezikshmërinë e autorit dhe veprës penale. Kështu, në një rast për vjedhjen e një viçi me vlerë 16.000 lekë,nga prokurori Kadri Skera, jane kërkuar per te dy autoret masat e sigurimit "arrest në shtëpi", për të cilët më pas,prokurore Doloret Velaj ka kryer hetime te mangeta dhe ka pushuar hetimet. Ndonëse ky vendim pushimi është shfuqizuar nga titullari i prokurorisë, duke i lënë detyra të reja, ato nuk jane kontrolluar dhe çështja është pushuar përsëri.

Më poshtë po japim një rast nga më tipikët: në një procedim penal të regjistruar për krimin e plagosjes së rëndë me pasoje vdekje, në bazë të nenit88/2 i Kodit Penal, prokurori Artan Tozaj mer përsipër të kryejë të gjitha hetimet vetë, duke shkelur Urdhërin e Prokurorit të Përgjithshëm Nr.45 datë 05.05.1999, qe përcakton sene te gjitha rastet kur ndjekja penale fillon mbi materialet e ardhura nga policia, duhet të hetojë të paktën një nga oficerët e policisë gjyqësore të Komisarariatit të Policisë. Në fakt mbas marrjes persipërtë procedimit penal ka zvarritur hetimet,duke mos kryer për dy muaj rresht asnjë veprim hetimor. Ka

nxjerë me 2 muaj vonesë urdhërin për ndalimin e shtetasit B.K. në një kohë kur nga materialet e dërguara nga policia, vërtetohej se autori i krimit ishte pikërisht ai person. Gjithashtu gjatë përfaqësimit të akuzës në gjykim, në kundërshtim me kërkesat e nenit 53 të Kodit Penal ka kërkuar uljen e dënimit nën kufijtë e parashikuar nga ligji, e konkretisht 4 vjet burg. Në këtë rast ka shkelur edhe Udhëzimin e Prokurorit të Përgjithshëm Nr.30 datë 07.04.1999, ku përcaktohet qëndrimi që duhet të mbajë prokurori në gjykimet e shkurtuara, si dhe nuk e ka apeluar Vendimin e Gjykatës e cila e dënoi me 2 vjet burg.

Paplotshmeria në hetime dhe zvarritjet kanë sjellë jo në pak raste pushimin e çështjeve penale. Psh. Proçedimi penal Nr.1024 viti 2001,1 prokurorit Blerim Tominaj, është regjistruar për krimin e armëmbajtjes pa leje nën 278/2 të K.Penal, mbi bazën e kapjes në flagrancë të dy pushkëve në një veturë, të cilat policia i ka sekuestruar. Prokurori në kundërshtim me nenin 301/2 të K.Pr.Penale nuk ka bërë vlerësimin e sekuestros dhe më pas ka zvarritur për 2 muaj e gjysëm, vendimin për ekspertim teknik të armëve. Kur erdhi akti i ekspertim teknik, konkluzioni ishte se pushkët nuk realizonin qitje, mbasi gjilpëra nuk godiste kapsollën. Në këto rrethana, pa hetuar mbi parregullsitë lidhur me administrimin e armëve, vonesën e ekspertimit dhe pa vërtetuar shkencërisht shkakun e demtimit të gjilpërave, është vendosur pushimi i çështjes me arsyetimin se fakti nuk përbën vepër penale nën 328/1 b të K.Pr.Penale. Gjatë kontrollit dhe studimit të dosjeve penale të pushuara, në 10' prej tyre u konstatuan shkelje të rënda, e për këtë shkak u shfuqizuan vendimet e pushimit Për shumicën urdhëruam plotësimin me detyre të reja si dhe dërgimin në Gjykatë.

4-Probleme ligjore të evidentuara në procedimet penale të dërguara në gjyq dhe të gjykuara.

Perfaqësimi në gjyq i çështjeve penale, është detyrë tepër e rëndësishme dhe profesionale, e cila duhet të kryhet me korrektesë dhe në zbatim të kërkesave të ligjes penale e proceduriale dhe urdherave të Prokurorit të Përgjithshëm.

Kërkesa e prokurorit për llojin dhe masën e dënimit duhet të jetë e studjuar mirë, mbi bazën e të gjitha rrethanave dhe të përgjigjet me efikasitet rrezikshmerisë së krimit dhe autorit.

Në Prokurori të Rrethit Tiranë, për periudhën objekt kontroli, në teresi u vërejt një politikë liberale dënimi dhe në disa raste në shkelje flagrante të ligjes penale e proceduriale. Me qëllim për ta konkretizuar sa më siper po japim disa shembuj:

Në gjykimin e dy të pandehurve të akuzuar për vjedhje me dhunë, në bazë të nenit 139-25 të K.Penal, gjatë seancave gjyqësore prokurore Irena Vujoshi, në bazë të nenit 372 të K.Pr.Penale, kerkoi ndryshimin e akuzës së mesiperme, në kundërvajtjen penale të rrahjes nën 90/lit.K.Penal, pa e diskutuar çështjen në Prokurori të Përgjithshme. Ky qëndrim përben shkelje të Urdhërit të Prokurorit të Përgjithshëm Nr.11 datë 06.03.2000.

Në një rast tjetër, ndonëse prokurore Dolores Velaj, pushoi akuzën për një të pandehur dhe sugjeroi pezullimin e çështjes, ky vendim u shfuqizua nga prokurori me i lartë dhe autori ju dërgua gjyqit. Në konkluzionet përfundimtare në Gjykatë, kjo prokurore midis të tjerave shprehet; "...në mbështetje të nenit 24/4 të K.Pr.Penale urdherat e prokurorit me të lartë janë të detyrueshme për prokurorin me të ulët, i kërkoj gjykatës deklarimin fajtor të pandehurit D.K.për krimin e vrasjes për shkak të cilesive të vecanta të viktimes, nën 79/c të K.Penal dhe dënimit me 20 vjet burg...". Sot kjo çështje është gjykuar nga Gjykata e Apelit Tiranë dhe i pandehuri D.K. është dënuar me burgim të përjetshëm.

-Gjatë kontrollit u evidentuan kërkesa të prokuroreve jashtë kritereve të neneve 53 dhe 59 të K.Penal, për ulje të masës së dënimit nën minimumin e

parashikuar nga dispozita perkatese dhe pezullime te ekzekutimit te vendimeve. Po sjellim nje shembull: ne gjykimin e te pandehures Sh.R. e deklaruar fajtores per tentative vrasje dhe armembajtje pa leje ne baze te neneve 76-22 dhe 278/2 te K.Penal, prokurori Etjen Kapo ka kerkuar denimin me 8 vjet burg, duke aplikuar nenin 59 te K.Penal me nje afat 3 vjet, kur sipas kesaj dispozite afati i proves mund te zbatohet vetem per denime deri ne 5 vjet burg.

Gjithashtu ne disa raste duheshin apeluar vendimet e dhena, nga Gjykata e shkalles se Pare, per shkak se ato kane qene shume te ndryshme nga kerkesa e prokuroit ose teper liberale. Konkretisht: Autori R.D eshte derguar ne gjyq, me akuzen e parashikuar nga nenet 76-22 e 278/2 te K.Penal. ProkurorVioleta Veshi, ne seancen perfundimtare, ka kerkuar denimin nen minimumin e dispozies, me 5-vjet burg duke aplikuar nenin 53 te K.Penal. Gjykata e ka denuar me 2-vjet burg.

-Kujdes i veçante duhet bere ne perpilimin e kerkesave per dergimin e çeshtjeve ne gjyq dhe konkluzioneve perfundimtare, ku pjesen kryesore, nuk duhet ta zere pershkrimi i ngjarjes, me detaje te panevojshme, por paraqitja e provave dhe argumentave ligjore qe vertetojne akuzen ne ngarkim te autoreve. Ne Prokurori te Rrethit Tirane, keto kerkesa dhe sidomos konkluzionet perfundimtare ishin te perpiluara pa nje nivel te mire profesional.

5-Probleme te organizimit te punes

Në Prokurori të Rrethit Tiranë, ishin mbartur për vitin 2002, 641 proçedime penale, nga te cilat u gjetën ende në hetim në muajin maj 2002, 196 proçedime penale me 103 të pandehur, të rregjistruara gjate vitit 2001, për krime të lehta ose kundërvajtje penale, ne te cilat ishin kryer shume pak veprime hetimore.

E vlen te theksojme edhe nje fakt tjeter: Për mungesë kontrolli e përgjegjësie dhe zvarritje në studimin e dosjeve nga drejtuesit e prokurorisë, nuk ishin ç'rregjistruar duke u llogaritur të mbartura për vitin 2002, 130 proçedime penale, për të cilat hetimet ishin përfunduar gjatë vitit 2001.

-Veç sa me siper theksojme edhe nje problem, lidhur me plotesimin e kapakeve te dosjeve e sidomos te fashikujve te prokurorit per çeshtjet derguar gjykates. Ne keta fashikuj duhet te gjejne pasqyrim, perveç emrave te pandehurve, akuzes edhe kerkesa e prokurorit per liojin dhe masen e denimit si dhe vendimi i gjykates.

-Per shkeljet e konstatuara ne veprimtarine e prokuroreve te Prokurorise se rrethit Tirane, Prokurori i Pergjithshem, mori keto masa disiplinore:

I propozoi Presidentit te Republikes, per shkarkimin nga detyra te prokuroreve; Artan Tozaj, Dolorez Velaj, Arban Tutulani dhe Violeta Veshi, te cilet me dekret te Presidentit te Republikes u larguan nga detyra e prokurorit.

Ju dha "verejtje me paralajmerim per shkarkim nga detyra", prokuroreve: Shkelqim Gani, Dritan Ribaj, Saimir Hysa e Irena Vujoshi.

Ju dha "verejtje", prokuroreve: Gjon Kodra, Bledar Bejko, Elio Mazreku dhe Etien Kapo.

-Pergjithesimi te njihet nga te gjithe prokuroret dhe oficeret e policise gjyqesore. Merrni masat e nevojshme, ligjore dhe organizative me qellim qe ne te ardhmen te zbatohen me korrektesi dhe profesionalizem te larte kerkesat e ligjit penal e procedural si dhe Urdherat dhe Udhezimet e Prokurorit te Pergjithshem.

PROKURORI I PERGJITHSHEM

THEODHORI SULLAK



